



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 164, Datë 22.10.2020

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “RREGULLAVE PËR
MONITORIMIN E TREGUT TË GAZIT NATYROR”.**

Në mbështetje të nenit 16; të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; nenit 16; të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.10.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 114/1 Prot, datë 16.10.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullave për monitorimin e tregut të Gazit Natyror”,

Konstatoi se:

- Draft Rregullat për Monitorimin e Tregut të Gazit Natyror u hartuan si dokument bazuar në Ligjin 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar, dhe përcaktojnë mënyrën dhe procedurat për monitorimin e funksionimit të Tregut të Gazit Natyror si dhe veprimtari të caktuara të Operatorëve të Transmetimit dhe të Shpërndarjes për funksionimin e Tregut të Gazit Natyror në Republikën e Shqipërisë.
- Monitorimi dhe kontrolli i funksionimit të tregut të gazit natyror realizohet nga Enti Rregullator i Energjisë dhe ka për qëllim rritjen e efikasitetit, konkurrencës dhe transparencës së tregut të gazit natyror, si dhe identifikimin e parregullsive.
- Monitorimi i funksionimit të tregut të gazit natyror ka të bëjë me mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave dhe të informacionit, si dhe publikimin e informacionit sipas Nenit 3 të këtyre Draft Rregullave.
- Të gjithë pjesëmarrësit në tregun e gazit natyror (tregtarët, furnizuesit, furnizuesit e mundësisë së fundit, operatorët e transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit si dhe sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi të licensuarit në depozitim apo operim GNL, duhet të informojnë periodikisht në lidhje me numrin e klientëve si dhe kategorizimin e tyre sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.
- Kjo Draft Rregullore parashikon detyrimet e të licensuarit në veprimtari të transmetimit, të shpërndarjes dhe të furnizimit, të furnizuesit të mundësisë së fundit për

të përcjellë në ERE të dhënat dhe informacionet e nevojshme në lidhje me cilësinë e sigurimit të shërbimeve tregtare.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullave për Monitorimin e Tregut të Gazit Natyror” në Shqipëri.
2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI